



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE

AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

Dok. No. 686/23
Date: 04.04.2023
Page No. 03
Nro. Faz. Nr. Etap. Nr. Page.

06/01 03 04.04.2023

LABORATORIUS ETHERICUM SINI CORRUPTIONI

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagradi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagradi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 04.04.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbylllet rasti DPKI-06-196/23, për zyrtarin z. Sehad Kadiri, Fizikan Mjekësor në Klinikën e Onkologjisë në QKUK, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për z. Sehad Kadiri, Fizikan Mjekësor në Klinikën e Onkologjisë në QKUK, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet vijuese për konflikt të interesit të z. Sehad Kadiri, citojmë:

"Paraqet konflikt interesit që një punonjës i SHSKUK-së z. Sehad Kadiri, (që është edhe shefi i shërbimit të dozimetrisë në Institutin e Mjekësisë së Punës në Obiliq), të lexojë dozimetrat e gjithë punonjësve shëndetësorë ku tregohet niveli i rrezatimit të tyre?

Sa janë të besueshme për QKUK-në raportet që vijnë nga IMP në Obiliq nëse kjo nuk është konflikt interesit?

A është konflikt interesit nëse po ky zyrtar i SHSKUK-së dhe njëherit shefi i dozimetrisë në Institutin e Mjekësisë së Punës, bën ekspertiza për kompanitë private që punojnë me rrezatim jonizues, duke ditur se këto kompani kanë kusht kryerjen e ekspertizave për licencimin në Agjenci për Mbrojtje nga Rrezatimi. Ndërkohë nuk ka asnjë institucion tjetër që bën këto kontrata me sektorin privat?".

Agjencia për Parandalimin e Korruptionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-01/317/23, e ka njoftuar zyrtarin z. Sehad Kadiri lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit dhe më pas ka organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit si dhe me informatat që posedon Agjencia për Parandalimin e Korruptionit, lidhur me këtë rast.

Në takim janë diskutuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij në cilësinë e zyrtarit publik si fizikan mjekësor në QKUK, pastaj angazhimi i tij në kuadër të Shërbimit për Mbrojtje nga Rrezatimi në cilësi të Fizikanit - Specialistit për mbrojtje nga rrezatimi në IMP Obiliq, si dhe ekspertizat në cilësi të ekspertit (të pavarur) të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore (AKMRRSB).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit është fokusuar veçanërisht tek rastet e mundshme të konfliktit “*rast për rast*” të interesit me rastin e ushtrimit të funksioneve (veprimtarive) të sipërpërmendura nga ana zyrtarit në fjalë, duke pasur parasysh se vendimmarrja në një çështje të caktuar e cila ka të bëjë me ekzistencën e interesit privat të zyrtarit ose të personave të afërm, mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit. Zyrtari në fjalë ka mohuar mundësinë e çfarëdo interferimi apo vendimmarrjeje me konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksioneve (veprimtarive) në fjalë.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtij rasti, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit gjithashtu ka kërkuar dhe siguruar dokumentacionin plotësues nga z. Sehad Kadiri (Nr. protokolli: Dep.06-317-1/23).

Nga kërkesa e raportuesit të rastit për iniciimin e procedurës së hetimit administrativ, takimin e mbajtur me zyrtarin z. Sehad Kadiri dhe dokumentacioni në dispozicion, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka konstatuar gjendjen si në vijim:

Nga muaji tetor, 2007 e në vazhdim (nga 09.2017, bashkëpunëtor i jashtëm), është punësuar në Institutin e Mjekësisë së Punës Sh.A.¹ në kuadër të Shërbimit për Mbrojtje nga Rrezatimi në cilësi të Fizikanit - Specialist për mbrojtje nga rrezatimi. Deri në fund të Janarit, 2023, ka mbajtur pozitën e Shefit të Shërbimit për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe ka qenë i zgjedhur anëtar i Bordit Drejtues të Institutit të Mjekësisë së Punës SH.A., Obiliq. Më 31 Janar, 2023, ka dhënë dorëheqje nga këto (dy) pozita;

Nga muaji prill, 2013 e në vazhdim është punësuar në QKUK, Prishtinë, në cilësi të Fizikanit mjekësor dhe nuk mban asnjë pozitë menaxheriale;

Nga muaji tetor, 2017 e në vazhdim, është ligjërues (profesor) në një kolegji privat, dhe nuk mban pozitë menaxheriale;

Sipas shkresës së titulluar “*Njoftim për Dorëheqjen nga pozita e Shefit të Shërbimit për Mbrojtje nga Rrezatimi*”, me nr. protokolli 984/3-z, të Institutit të Mjekësisë së Punës në Obiliq, z. Sehad Kadiri, me datë 31.01.2023, paraqet dorëheqjen e tij të parevokueshme nga pozita e Shefit të Shërbimit për Mbrojtje nga Rrezatimi, në Obiliq;

Ndërsa, sipas shkresës së titulluar “*Njoftim për Dorëheqjen nga pozita e anëtarit të Bordit Drejtues të IMP Sh.A., në Obiliq*”, me nr. protokolli 985/3-z, të Institutit të Mjekësisë së Punës në Obiliq, z. Sehad Kadiri, me datë 31.01.2023, paraqet dorëheqjen e tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Bordit Drejtues të IMP Sh.A., në Obiliq.

Fillimisht, z. Sehad Kadiri në cilësinë e Fizikanit Mjekësor në Klinikën e Onkologjisë në QKU, është person zyrtar në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku përcaktohet se: “*Person zyrtar - nënkupton çdo person tjeter të zgjedhur ose të emëruar në një organ shtetëror si edhe personat zyrtarë të*

¹Instituti i Mjekësisë së Punës SH.A. në Obiliq është institucion privat me status shoqëri aksionare (SH.A.), i regjistruar pranë ARBK-së.

përcaktuar sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës që ushtrojnë detyra publike dhe që nuk përfshihen në nën-paragrafin 1.3. të këtij nenit”.

Pra, pozita e tij si Fizikan Mjekësor në Klinikën e Onkologjisë në QKU, nuk është pozitë e zyrtarit të lartë në kuptim të *nënit 3 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3* të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, lidhur me *nën 3 paragrafi 1, të Ligji Nr. 04/L-050* për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, prandaj në këtë rast nuk vleinë kufizimet apo ndalesat eventuale që parashihen me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, për ‘*Zyrtar të Lartë*’.

Në këtë kontekst, ushtrimi i funksionit publik nga zyrtari z. Sehad Kadiri, si dhe angazhimet tjera private të sipërpërmendura, apriori nuk bien ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Konflikti i interesit është i lidhur ngushtë më vendimmarrjen në çështje dhe nën kushte të caktuara, ndërsa në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korruptionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, pasi që nuk ka gjetur se gjatë ushtrimit të funksionit publik nga z. Sehad Kadiri në cilësinë e Fizikanit Mjekësor në Klinikën e Onkologjisë në QKUK, si dhe angazhimet tjera private të sipërpërmendura, të këtë pasur ndonjë vendimmarrje me konflikt interesit nga zyrtari në fjalë.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

Yll Buleshka
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korruptionit

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)